

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Trepça SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **12997 12998-26-4074-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me ngarkues nëntokësorë për ngarkimin e xehes**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Segment Kosova SH.P.K.
NUI	810871328
Adresa	Lagja Marigona, Preoc, Gracanice
Vendi	Gracanice
Kodi postar	10500
Numri Telefonit	+38338733794
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Ilir Zhabari
Adresa elektronike	procurement@segment-rks.com
Data e parashtrimit të ankesës	18.08.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me ngarkues nëntokësorë për ngarkimin e xehes

Me datë 03.06.2026, Autoriteti Kontraktues – Trepça Sh.A., përmes Njoftimit për Kontratë (“Njoftimi për Kontratë”) ka hapur procesin e Prokurimit Publik me nr. të prokurimit 12997 12998-26-4074-1-1-1, me titull “Furnizim me ngarkues nëntokësorë për ngarkimin e xehes” (“Aktiviteti Prokurues”). Vlera maksimale e këtij Aktiviteti Prokurues sipas Njoftimit për Kontratë parashikohej të ishte 690,000.00 EUR.

Me datë 14.07.2026 është bërë hapja e tenderit, me tri (3) oferta të cilat janë dorëzuar. OE Segment Kosova Sh.P.K. (“OE”), sipas Raportit të Vlerësimit, të datës 24.07.2026 (“Raporti i vlerësimit”), ka marrë pjesë në këtë tender me a) një ofertë tërësisht të përgjegjshme, b) me çmimin më të lirë ofertues nga të gjitha ofertat, me një ofertë prej 688,900.00 EUR, c) dhe nën vlerën maksimale të miratuar nga AK, si më lart. Madje, nga po ky Raport i vlerësimit, OE Segment Sh.P.K. u identifikua si OE i rekomanduar për dhënien e kontratës.

Megjithatë, përkundër cilësimit të OE si OE i rekomanduar për dhënien e kontratës, më datë 31.07.2026 AK nxjerrë Njoftimin Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues (“Njoftimi i AK”). Ky vendim i cili duhej të shpërblente OE Segment Kosova Sh.P.K me kontratë, përkundrazi anulon Aktivitetin e Prokurimit, me justifikimin se mungojnë mjeteve buxhetore për realizimin e tij.

Ky pretendim për mungesë e mjeteve buxhetore të AK është e pabazuar dhe në kundërshtim me ligjin, për shkak se Zyrtari Kryesor Administrativ (“ZKA”) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (“ZKF”) i AK përmes nënshkrimit të Deklaratës së Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve, e datës 16.03.2026, kanë konfirmuar se fondet janë në dispozicion për realizimin e objektit të tenderit.

Më datë 04.08.2026, OE Segment Kosova Sh.P.K ka paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim. Ndërsa me datë 10.08.2026, Autoriteti Kontraktues nxjerrë Vendimin për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim (“Vendimi për refuzim”), ku ri-përsëritet qëndrimi i AK se për shkak të shkurtimeve buxhetore nga ana e Ministrisë së Ekonomisë së Kosovës, mjetet buxhetore nuk janë në dispozicion.

Autoriteti Kontraktues po ashtu i bashkëngjet Vendimit për Refuzim Deklaratat për Arsyetimin e Mungesës së Mjeteve Buxhetore për realizimin e aktivitetit prokurues, të lëshuara individualisht nga ZKA dhe ZKF të AK, të datës 31.07.2026 (“Deklaratat për Arsyetimin e Mungesës së Mjeteve Buxhetore”), ku ZKA dhe ZKF deklarojnë se është kryer ri-alokimi i mjeteve buxhetore dhe prandaj të njëjtat nuk janë në dispozicion. Pra, ZKA dhe ZKF ofrojnë arsyetim në kundërshtim me arsyetimin e paraqitur në Vendimin për refuzim.

Si rezultat i kundërligjshmërisë së anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit dhe kundërthënies në arsyetimet e ofruara nga AK, OE Segment Sh.P.K dorëzon këtë Ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit (“OSHP”).

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kemi bërë Kërkesë për Rishqyrtim, por Autoriteti Kontraktues ka Refuzuar si të pabazuar Kërkesën tonë për Rishqyrtim.

Bashkangjitur është Kërkesa për Rishqyrtim dhe Vendimi i Autoritetit Kontraktues.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji Nr. 04/L-042 Për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, duke përfshirë Ndryshimet dhe Plotësimet përmes Ligjit Nr. 04/L-237, Ligjit Nr. 05/L-068, dhe Ligjit Nr. 05/L-092 (“LPP”)

-

Neni 7 – Barazia në Trajtim / Jodiskriminimi - AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit vetëm pasi është bërë e qartë se OE Segment Kosova ka paraqitur ofertë e cila duhet të shpërblehet me Kontratë, kjo vërtetuar me Raportin e Vlerësimit, ku qartësohet se OE Segment Kosova ka paraqitur ofertë të përgjegjshme me çmimin më të lirë.

Neni 9 – Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur - AK ka përcaktuar paraprakisht nevojat që duhen përmbushur përmes tenderit dhe ka përcaktuar vlerën e parashikuar për përmbushje të atyre nevojave. Vetëm katër muaj më pas, tani, AK, në kundërshtim me ligjin, pretendon se kjo vlerë e parashikuar dhe e aprovuar paraprakisht është bërë e padisponueshme për nevoja të këtij aktiviteti të prokurimit.

Neni 62 – Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit - Pas hapjes së ofertave dhe përfundimit të vlerësimit, oferta e Segment Kosova është vlerësuar si ofertë e përgjegjshme dhe e cila ka pasur çmimin më të ulët, dhe gjithashtu ka qenë në përputhje me buxhetin e alokuar sipas Deklaratës së Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve. Anulimi i aktivitetit tenderues në këtë fazë është i paligjshëm pasi asnjë nga kushtet ligjore për anulim nuk është përmbushur, sikurse përcaktohet me nenin 62 të LPP. OE ka paraqitur një ofertë tërësisht të përgjegjshme, me çmimin më të ulët ofertues dhe nën vlerën maksimale të aprovuar nga AK, dhe nuk është dëshmuar ndonjë rrethanë ligjore që justifikon ndërprerjen e procedurës.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

OE Segment Kosova ka paraqitur ofertë të përgjegjshme dhe është rekomanduar për shpërblim me kontratë sipas Raportit për vlerësim të nxjerrur nga AK. Përkundër kësaj, AK përmes Njoftimit anulon aktivitetin e prokurimit duke arsyetuar se ka mungesë të mjeteve buxhetore për realizimin e aktivitetit të prokurimit. Kjo në kundërshtim të plotë të Deklaratës së Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve, e datës 16.03.2026, të nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar i AK, e cila konfirmon se fondet janë në dispozicion për realizimin e objektit të tenderit.

Edhe pas pranimit të Kërkesës për rishqyrtim të OE ndaj Njoftimit të AK, AK pa ofruar as edhe një kundërshtim ndaj asnjë prej pretendimeve të posaçme që ka ngritur OE, dhe duke deklaruar se për shkak të **rialokimit të mjeteve buxhetore**, të njëjtat nuk janë në dispozicion për realizimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Vendimit për Refuzim Deklaratat për Arsyetimin e Mungesës së Mjeteve Buxhetore për realizimin e aktivitetit prokurues, të lëshuara individualisht nga ZKA dhe ZKF të AK, të datës 31.07.2026, ku ZKA dhe ZKF deklarojnë se për shkak të kryerjes së ri-alokimit të mjeteve buxhetore, të njëjtat nuk janë në dispozicion për qëllime të këtij tenderi. ZKA dhe ZKF përmes Deklaratave për Arsyetim të Mungesës së Mjeteve Buxhetore, ofrojnë arsyetim kontradiktor ndaj arsyetimit të ofruar në Vendimin për refuzim. Derisa Vendimi për refuzim arsyeton anulimin bazuar në shkurtime të fondeve nga ana e Ministrisë së Ekonomisë, ZKA dhe ZKF arsyetojnë anulimin thirrur në ri-alokim të fondeve; pra, duke rrëfyer se fondet nuk janë objektivisht të padisponueshme por subjektivisht, meqenëse të njëjtit kanë vendosur që fondet t'i dedikojnë çështjeve tjera.

Siç do argumentohet më hollësisht në vijim, i ri-kujtojmë OSHP-së se rialokimi i fondeve të disponueshme për një aktivitet të prokurimit pas hapjes së ofertave të atij aktiviteti të prokurimit është tërësisht në kundërshtim me ligjin. Për më tepër, ky veprim i kundërligjshëm përmbanë në vete elemente diskriminuese, ku AK duke synuar pa kompromis mos-shpërblimin e OE me kontratë edhe pse fondet janë të disponueshme, pas konstatimit të përgjegjshmërisë së OE Segment Kosova, vendosë që për arsye të përmbushjes së qëllimeve të veta, të anulojë këtë aktivitet prokurimi jashtëligjshëm.

Si rrjedhojë, përmes kësaj Ankese në OSHP, OE konsideron Vendimin e AK për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim të kundërligjshëm, diskriminues, dhe kundërtëhënës, dhe prandaj ripërsëritë pretendimet e paraqitura ndaj AK, dhe me respekt kërkon nga OSHP që të shpallë këtë Ankese tërësisht të bazuar, për shkak se:

1. Nuk janë përmbushur kushtet ligjore për anulimin e aktivitetit të prokurimit;
2. OE ka paraqitur ofertë të përgjegjshme me çmimin më të ulët ofertues;
3. Anulimi i aktivitetit të prokurimit është diskriminues

Pretendimi ankimor 1: Nuk janë përmbushur kushtet ligjore për anulimin e aktivitetit të prokurimit

OE konteston në tërësi Vendimin e AK për refuzim dhe Njoftimin e AK përmes së cilit anulohet aktiviteti i prokurimit duke u thirrur në mungesë të mjeteve financiare për të

shpërblyer OE me kontratë, sepse ky anulim i aktivitetit të prokurimit nuk përmbanë asnjë bazë ligjore.

Siç është cekur më lart, AK nuk mund të thirret as në shkurtim të supozuar të fondeve e as në ri-alokimin e tyre si bazë ligjore për anulim të aktivitetit të prokurimit në këtë fazë të zhvillimit të procedurës së këtij prokurimi publik.

Neni 62 i LPP shprehimisht ka përcaktuar shkaqet për të cilat mund të përfundohet një aktivitet i prokurimit. Paragrafi 1 i Neni 62 të LPP përcakton rastet kur autoriteti kontraktues **obligohet** të anulojë një aktivitet prokurimi, megjithatë ky paragraf nuk aplikohet sa i përket Njoftimit të AK sepse nuk ka asnjë bazë për pretendime të shkeljeve të LPP nga OE.

Në këtë drejtim, nënparagrafët 2.1. dhe 2.2., të Neni 62 të LPP përcaktojnë si më poshtë:

*“2. Autoritetet kontraktuese **mund** të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njëërën nga arsyet:*

2.1. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.”

Sa i përket rastit nga nënparagrafi 2.1., ndërlidhemi me Nenin 9, paragrafi 5, i LPP, i cili ka paraparë si më poshtë:

“5. Si dëshmi se autoriteti kontraktues është pajtuar me paragrafët 1. deri 4. të këtij neni, ZKA dhe ZKF do të përgatisin dhe nënshkruajnë një “Deklaratë të Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve”. Deklarata e tillë e Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve do të përmbajë informatat në vijim:

(i) një deklaratë të nevojave me shkrim, e cila i përmbledh rezultatet e vlerësimit të nevojave që është bërë nga autoriteti kontraktues sipas paragrafit 1. të këtij neni,

(ii) një deklaratë me shkrim që konfirmon disponueshmërinë e fondeve, që demonstroi se autoriteti kontraktues i ka përmbushur obligimet e tij sipas paragrafit 2. të këtij neni...”

AK ka lëshuar përgjatë Aktivitetit të Prokurimit dokumentin e theksuar më lart në raport me Nenin 9 të LPP, **katër muaj para hapjes së tenderit**. Sipas këtij dokumenti, konkretisht Deklaratës së Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve, të lëshuar nga AK më datë 16.03.2026, vlera e parashikuar e tenderit ka qenë nën 690,000.00 EUR. Bazuar në këtë planifikim buxhetor, **AK ka dëshmuar qartë se kushtet financiare dhe ligjore për realizimin e aktivitetit kanë qenë të përmbushura**.

OE ka marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit me një ofertë në vlerë prej 688,900.00 EUR, pra, nën shumën maksimale të dedikuar për realizimin e tenderit. Si rezultat, meqenëse oferta e OE nuk tejkalon limitin buxhetor të përcaktuar nga AK, kushtet për anulim të tenderit që rrjedhin nga nënparagrafi 2.1. i Nenit 62 LPP nuk janë përmbushur.

Po ashtu, sa i përket rastit nga nënparagrafi 2.2. i Nenit 62 të LPP, përsëri nuk përmbushet as ky kusht për anulim të tenderit sipas nevojës. Sikurse figuron në këtë nënparagraf të cekur më lart, ashtu që AK të anulojë aktivitetin e prokurimit mbi këtë bazë, AK ishte dashur që para hapjes së tenderëve: a) të anulojë tenderin duke demonstruar arsyen e anulimit në rast të ngjarjes objektive, dhe/ose b) të anulojë tenderin së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve në rast të ngjarjes të paparashikuar dhe/ose përtej kontrollit të AK.

Megjithatë, anulimi i aktivitetit të prokurimit nuk ka respektuar asnjë ndër këto kushte që do i ofronin AK bazë ligjore për anulim. AK nuk ka demonstruar para hapjes së tenderëve asnjë arsye që vërteton se anulimi ka ardhur si shkak i ngjarjes objektive – pra, nuk është

vërtetuar mungesa e buxhetit i cili veçse ka qenë i predestinuar formalisht përmes Deklaratës së Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve. Njëashtu, AK përmes Njoftimit nuk ka arsyetuar dhe as nuk është thirrur në një ngjarje të paparashikuar dhe/ose përtej kontrollit të AK.

Në konsideratë të faktit se asnjë nga kushtet për anulim të ligjshëm të aktivitetit të prokurimit, siç janë përcaktuar në Nenin 62 LPP, nuk janë përmbushur, dhe faktit se AK përmes Vendimit për refuzim nuk ofron as dhe një argument kundërthënës, atëherë konkludohet se anulimi i tenderit nuk është i ligjshëm. Prandaj, kërkojmë me respekt nga OSHP që të aprovojë këtë Ankesë, të anulojë Vendimin për refuzim dhe Njoftimin e AK, ashtu që OE të shpërblehet me kontratë.

Pretendimi ankimor 2: OE ka paraqitur ofertë të përgjegjshme me çmimin më të ulët ofertues

Meqenëse kushtet për anulim të aktivitetit të prokurimit nuk janë përmbushur, OE i ripohon OSHP-së se OE Segment Kosova Sh.P.K. është a) shpallur ofertues i përgjegjshëm, b) ka ofruar çmimin më të ulët ofertues, dhe c) ka paraqitur ofertë nën shumën maksimale të ofertimit.

Përgjegjshmëria e plotë e OE në këtë aktivitet prokurimi është e pakontestueshme, sepse kjo përgjegjësi është ri-afirmuar nga vet AK. Përgjatë Raportit të vlerësimit, lëshuar nga AK, OE konsiderohet i përgjegjshëm në çdo kategori ekzistuese. Po ashtu, cilësohet si ofertuesi i përgjegjshëm me çmimin më të lirë, dhe prandaj në faqen 9 të Raportit të vlerësimit OE konsiderohet si OE i rekomanduar për shpërblim me kontratë.

Marrë parasysh të lartcekurat, kërkojmë me respekt nga OSHP që të aprovojë këtë Ankesë si të bazuar, ashtu që të anulohet Vendimi për refuzim i nxjerrur nga AK, përmes së cilit ka vendosur në kundërshtim me ligjin që të refuzojë Kërkesën për rishqyrtim dhe të anulojë aktivitetin e prokurimit.

Pretendimi ankimor 3: Anulimi i aktivitetit të prokurimit është diskriminues

Neni 7 i LPP përcakton qartë parimin e trajtimeve të barabarta dhe mosdiskriminimit, sipas të cilit Autoriteti Kontraktues është i obliguar që t'i trajtojë të gjithë Operatorët Ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe të mos ndërmarrë asnjë veprim apo vendim që dëmton apo favorizon padrejtësisht një OE në raport me të tjerët.

Njoftimi i AK, përveç se është i paligjshëm siç është elaboruar në Pretendimin Ankimor nr. 1, paraqet edhe shkelje të drejtpërdrejtë të parimit të barazisë dhe transparencës. OE Segment Kosova Sh.P.K. ka qenë operatori i vetëm me a) ofertë të përgjegjshme e cila ka

përmbushur të gjitha kriteret teknike dhe administrative, b) që ka ofruar çmimin më të ulët ofertues, dhe c) që ka ofruar çmim në përputhje me buxhetin e aprovuar, dhe përkundër kësaj përgjegjshmërie të pakontestueshme – nuk është shpërblyer me kontratë.

Anulimi i procedurës në këtë fazë, pa bazë ligjore dhe objektive, krijon dyshim të bazuar se vendimi është marrë me qëllim të shmangies së lidhjes së kontratës me OE Segment Kosova Sh.P.K. dhe diskriminimin e këtij operatori ekonomik, kështu duke bërë shkelje të parimeve themelore të prokurimit publik, përfshirë transparencën, proporcionalitetin dhe konkurrencën e ndershme.

Shtesë kësaj, AK në vend së t'i adresojë pretendimet e OE Segment Kosova një-nga-një, thjeshtë deklarohet se i refuzon ato si të pabaza pa u lëshuar në arsyetim të këtij vendimi. AK me këtë qasje mospërfillëse ndaj pretendimeve të OE Segment Kosova Sh.P.K. shkelë parimet bazike mbi të cilat zhvillohet i tërë aktiviteti i prokurimit: transparencës dhe llogaridhënies, duke vënë në pikëpyetje të mëtutjeshme paanshmërinë e AK-së në këtë aktivitet prokurimi.

Po ashtu, kundërthëniet mes Vendimit për refuzim dhe Deklaratave për Arsyetim të Mungesës së Mjeteve buxhetore janë çështje të cilat konsolidojnë bindjen e bazuar të OE se AK është duke vepruar në qasje diskriminuese ndaj OE. Ndryshimi i arsytimit nga shkurtim i fondeve në ri-alokim të tyre, vë në pah natyrën e këtij anulimi si një veprim i improvizuar për t'i mohuar OE shpërblimin me kontratë. Pra, AK nuk ka asnjë arsye që objektivisht pamundëson shpërblimin e OE me kontratë, por ka arsye tendencioze tërësisht subjektive, dhe këto arsye nuk përbëjnë bazë ligjore për anulim të tenderit, por vetëm diskriminim ndaj OE.

Përfundimisht, bazuar në të lartcekurat, me respekt, kërkojmë nga OSHP që, pas shqyrtimit të kësaj ankese, të merr:

VENDIM

APROVOHET në tërësi si e bazuar Ankesa e paraqitur nga Operatori Ekonomik Segment Kosova Sh.P.K. dhe **ANULOHEN** Vendimi për Refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim i Autoritetit Kontraktues Trepça Sh.A., i datës 10.08.2026 dhe Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Trepça Sh.A., i datës 31.07.2026, për anulim të aktivitetit të prokurimit

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Operatori Ekonomik Segment Kosova Sh.P.K. është i detyruar të mbrojë interesat e tij ekonomike dhe ligjore. Rrjedhimisht, në rast të vazhdimit të veprimeve të kundërligjshme, OE në fjalë është i detyruar të veprojë me të gjitha mjetet ligjore në dispozicion, përfshirë kërkesat për kompensim të dëmeve eventuale të cilat kanë ndodhur dhe do të shkaktohen.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*